




QYTETARËT DHE GAZETARËT PËR PROFESIONALIZMIN MË MEDIA





**QYTETARËT DHE GAZETARËT
PËR PROFESIONALIZMIN
MË MEDIA**



QYTETARËT DHE GAZETARËT PËR PROFESIONALIZMIN MË MEDIA

Botuesit:

Shoqata për Zhvillim – Qendra për Menaxhimin e Ndryshimeve

Shoqata e Qytetarëve - Instituti i të Drejtave të Njeriut

Për botuesit:

Neda Maleska Saçmaroska

Margarita Caca Nikollovska

Autorë:

Jasna Bacovska Nedikj

Goce Pachemski

Redaktorë:

Iskra Belcheva-Ristovska

Ana Neshovska

Korrektura:

Ad Verbum

Disenji dhe botimi:

Brigada Design SHPK

Tirazhi:

150 ekzemplarë (Tirazhi falas/jokomercial)

CIP - Katalogizacija vo publikacija

Nacionalna i univerzitetska biblioteka „Св. Климент Охридски“, Скопје

316.774(497.7)

BACOVSKA Nedikj, Jasna

Qytetarët dhe gazetarët për profesionalizmin më media / [autorë Jasna Bacovska Nedikj, Goce

Pachemski]. - Shkup : Qendra për menaxhimin e ndryshimeve, 2017. - 36 стр. : граф. прикази ; 24 см

Фусноти кон текстот. - Публикацијата е во рамките на проектот: „Истражувачко новинарство чувар на демократијата и човековите права“. - Библиографија: стр. 36

ISBN 978-608-4818-25-0

1. Pachemski, Goce [автор]

а) Медиуми - Транспарентност - Македонија б) Етика во новинарството - Јавно мислење

COBISS.MK-ID 105322762

Publikimi është vënë në dispozicion në formë elektronike në: www.cup.org.mk dhe në www.ihr.org.mk

Ky publikim u përpilua në kuadër të Projektit “Gazetaria investigative – Rojë e demokracisë dhe e të drejtave të njeriut”, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i bashkë-financuar nga Ambasada Britanike Shkup. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se reflekton pikëpamjet e Bashkimit Evropian dhe të Ambasadës Britanike Shkup.



British Embassy
Skopje

HYRJE

Ky publikim është pjesë e projektit “Gazetaria huluntuose - roje e demokracisë dhe të drejtave të njeriut”, financuar nga Bashkimi Evropian dhe bashkë-financuar nga Ambasada Britanike në Shkup, ndërsa i zbatuar nga Qendra për Menaxhimin me ndryshime dhe Instituti i të Drejtave të Njeriut.

Qëllimi kryesor i këtij projekti është përforsimi mediave dhe organizatave të shoqërisë civile dhe mundësimin e një mjedisi të përshtatshëm për ushtrimin e lirisë së shprehjes dhe integritetin e medias, si një element kryesor për mbështetjen e mëtejshme të shtetit në procesin e aderimit në Bashkimin Evropian.

Liria e shprehjes është një e drejtë themelore në demokracinë perëndimore dhe është e lidhur direkt me lirinë dhe hapjen e mediave, dhe integriteti i tyre apo aftësia për të ofruar informata objektive dhe analitike. Në bazë të këtij informacioni është gazetaria cilësore, veçanërisht gazetaria huluntuose si lloj më elitë i gazetarisë. Kohët e fundit gazetaria huluntuose shpesh kontribuon për të përmbytur qeveri, arrestime të politikanëve, miratimin e ligjeve, zbulimin e gabimeve në punën e gjyqësorit dhe të ngjashme, dhe rezultatet e kësaj gazetarie pothuajse gjithmonë janë vlerësuar si shoqërisht të dobishme.

Te ne vitet e fundit liria e medias është një nga fushat ku Departamenti amerikan i Shtetit dhe Komisioni Evropian gjithashtu konstatojnë probleme të rëndësishme të cilat janë një pengesë për vendin në zhvillimin e saj demokratik dhe integrimin Euro-Atlantik. Tani më dy vite rresht, “Freedom House”, e rendit vendin në mesin e vendeve “jo të lira”¹, sidomos në segmentin e lirisë së medias. Ky është një alarm për të gjithë aktorët për të filluar zbatimin e ndryshimeve themelore në këtë sferë².

Zhvillimin e Gazetarisë huluntuose në vend e trajton grupi i ekspertëve i Komisionit Evropian i udhëhequr nga Rajnhard Pribe, i cili në raportin e tij të dytë në shtator 2017, ndër faktorët më të rëndësishëm që ndikojnë në zhvillimin e gazetarisë huluntuose në vend, i thekson mungesat e resurseve dhe aftësitë e veçanta gazetareske, si dhe prezencën e disa pengesave nga ana e autoriteteve të caktuara, që kufizojnë të drejtën e qytetarëve për qasje në informacione me kohë dhe objektive nga resurse të ndryshme.

Analiza në këtë publikim duhet të kontribuojë në arritjen e objektivit të projektit dhe në drejtim të: (1) përmirësimit e kushteve për gazetari cilësore dhe (2) krijimin e një klime të favorshme shoqërore dhe krijimin e një rregulloreje të duhur ligjore, bazuar në rekomandimet e BE-së për ushtrimin e lirisë së shprehjes dhe të mediave në vend.

Qëllimi i analizës ishte njohja e mendimit, apo perceptimi i publikut (qytetarëve), por edhe nga gazetaret mbi gjendjen në media dhe sidomos perspektivat për zhvillimin e Gazetarisë huluntuose në vendin tonë. Për të marrë parametrat relevante për këtë situatë janë realizuar dy anketime të veçanta telefonike. Në anketën e parë, realizuar në periudhën nga 30 maji deri më 9 qershor, ku morën pjesë 1, 203 qytetarë, dhe në rastin e dytë, e cila është realizuar në periudhën nga 27 qershori deri në 10 korrik 2017, ishin anketuar 163 gazetarë në pesë qytete: Shkup, Manastir, Kumanovë dhe Tetovë.

Nga analiza e anketave të qytetarëve që kanë marrë pjesë në të dy anketat rezultuan të dhëna interesante mbi nivelin e besimit në media, si dhe shkalla e profesionalizmit dhe reputacionin të gazetarëve në shoqërinë tonë. Analiza i tregon faktorët kryesorë që ndikojnë në situatën aktuale në skenën e medias, por i shënon në mënyrë të qartë hapat e nevojshëm që duhet

¹ Raporti Liria në botë 2017: <https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2017/macedonia>

² Gjendja në mediat dhe në gazetari në vendin tonë monitorohen vazhdimisht nga një numër i organizatave të tjera të njohura ndërkombëtare, të tilla si Reporterët pa Kufij ((Reporters Without Borders - RSF) dhe South East Europe Media Organisation (SEEMO)).

marrë palët e prekura, siç janë: shoqatat e gazetarëve, komuniteti akademik, sektori civil, institucionet shtetërore dhe mediat dhe gazetarët për të çuar përpara situatën në të cilën gjenden vet, si dhe të krijojnë kushte reale për zhvillimin dinamik të gazetarisë hulumtuese si roje e demokracisë dhe të drejtave të njeriut.

1. PERCEPTIMI I QYTETARËVE PËR MEDIAT DHE GAZETARINË

Korniza shoqërore për veprim të mediave dhe gazetarëve në vend

Më 24 dhjetor 2012, nga galeria e mysafirëve në Parlament, në mënyrë dramatike ishin dëbuar gazetarë që raportonin nga seanca e rregullt e parlamentit e përkushtuar në miratimin e buxhetit vjetor të shtetit. Ky precedent i ndjekur me dëbimin e deputetëve nga opozita, nga salla e kuvendit, e shënoi fillimin e një krize të zgjatur politike në të cilën u gjet vendi. Kjo ngjarje në një institucion që duhet të jetë “tempulli i demokracisë”, u bë simbol i situatës së vështirë me lirinë e shprehjes dhe mediave, si një nga çështjet shoqërore prioritare nga të cilat në masë të madhe varet zhvillimi demokratik i vendit.

Fillet e situatës së vështirë në media dhe gazetarinë në vend fillojnë nga koha e pavarësisë së vendit dhe fillimit të tranzicionit. Procesi i transformimit të sistemit mediatic, si pjesë e tranzicionit të përgjithshëm të shoqërisë, përfundoi me mediat funksionimi dhe mbijetesa e të cilëve varet vetëm nga ata që kanë para dhe pushtet politik. Transformimi i keq sidomos u ndje pas vitit 2001, vazhdoi me mbylljen e TV A1 televizioni i parë privat dhe gazeta ditore Vreme, dhe e arriti kulmin me mbylljen e gazetave nga MPM Grup, duke përfshirë gazetën e parë private të përditshme Dnevnik. Shumica e këtyre dukurive negative në media ndodhën gjatë sundimit të VMRO-DPMNE-së djathtiste³. Kontrolli mbi mbijetesën financiare të mediave dhe gazetarëve e mori përsipër shteti, d.m.th. partia në pushtet. Nga mjetet e informimit, mediat u kthyen në mjete për promovimin ekonomik dhe politik, të kontrolluara me anë të blerjes së hapësirës reklamuese nga shteti me vendim për dhënie të parave publike në mënyrë diskrete dhe jotransparente. Në Raportin vjetor të Komisionit Evropian për progresin e vendit në vitin 2014, u tha se “reklamimi qeveritar konsiderohet kontroll indirekt shtetëror mbi përmbajtjen që është prodhuar në media”⁴.

Si informohen qytetarët për zhvillimet më të rëndësishme shoqërore në vend?

Ehulumtimi empirik tregon se, në nivel global, me rritjen e internetit dhe on-line gazetarisë, te audiencia, veçanërisht në mesin e të rinjve, bie popullariteti i televizionit. Përkundër kësaj prirje globale, në vendin tonë 46.7% e të anketuarve në anketë deklaruan se informacionet në fushat më të rëndësishme shoqërore të tilla si politikë dhe ekonomi, qytetarët i marrin pikërisht nga televizioni. Dominimi i televizionit si një medium për informimin e qytetarëve konfirmohet përmes studimeve të tjera të rëndësishme, të tilla si ato të Institutit Ndërkombëtar Republikan (IRI)⁵ i cili në gusht të vitit 2017 ka regjistruar se 85% e qytetarëve në vend, lajmet më të rëndësishme nga politika i marrin nga televizioni. Gjithashtu analizat që i bën Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale (ASHMAA)⁶ tregojnë se televizioni mbetet mjeti më i rëndësishëm për informimin e qytetarëve në vend. Për shembull, analiza e tyre për vitin 2015

³ Komisioni Evropian: Raporti i Progresit për vitin 2013, në dispozicion në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2013/package/brochures/the_former_yugoslav_republic_of_macedonia_2013.pdf, Raporti i Progresit për vitin 2014, në dispozicion në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2014/20141008-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-progres-report_en.pdf, Raporti i Progresit 2015, në dispozicion në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2015/20151110_report_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia.pdf

⁴ Komisioni Evropian: Raporti i Progresit për vitin 2014, në dispozicion në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2014/20141008-the-former-yugoslav-republic-e-macedonia-progress-report_en.pdf

⁵ Hulumtimi i Opinionit Publik, në dispozicion në: http://www.iri.org/sites/default/files/2017-9-18_macedonia_poll.pdf


⁶ Analiza e Agjencia për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale në dispozicion: http://www.avmu.mk/images/Analiza_na_pazarot_na_audio_i_audiovizuelni_mediumski_uslugi_za_2015_godina.pdf

tregon se 74, 9% e popullsisë për ngjarjet vendase dhe të huaja të përditshme informohen nga televizioni.

Por, edhe pse shumica e të anketuarve mbi temat e rëndësishme shoqërore janë të informuar kryesisht përmes televizionit, internetit ende tregon një tendencë të vazhdueshme dhe të besueshme të popullaritet. Për këtë konstatim tregojnë të dhënat e anketës se 28.2% e të anketuarve preferojnë ueb portale, dhe 19.1% kanë zgjedhur rrjetet sociale si media për informacion.

Shumicën e informacioneve mbi politikën, ekonominë dhe çështje të tjera të rëndësishme sociale i marrim përmes:

- TV ditarit/lajmeve në televizion
- Lajme në radio
- Ueb portale
- Rrjetet sociale
- Mediat e shkruara (Edicioni në letër)
- Nuk e di / Refuzon të përgjigjet




Nga kjo vijon se, në total 47.3% e të anketuarve si burim kryesor të informacionit e përdorin internetin. Në të njëjtën kohë, ky hulumtim tregon qartë se mediat e shkruara, apo botimet e tyre në letër e humbin popullaritetin e tyre si media të informimit në lidhje me zhvillimet e rëndësishme shoqërore. Në fakt, vetëm 3.7% e të anketuarve janë ende të informuar nga gazetatat dhe revistat e botimeve të shtypura, që është tregues i habitshëm edhe për zhvillimin e gazetarisë hulumtuuese.

Një tregues tjetër i shprehive të mediave të qytetarëve në këtë vend është fakti se shumica e të anketuarve (81.7%) raportuan se, nga të gjitha televizionet në vend, më rregullisht i ndjekin televizionet private kombëtare (Sitel, Kanal 5, Telma, Alfa 24 Vesti...). Nivel të ulët të ndjekjes tregojnë televizionet on-line (2.7%), televizionet lokale (0.9%), televizionet e komuniteteve etnike (0.7%), televizionet e rajonit (1.2%) dhe rrjetet televizive globale botërore (5.7%).

I Cilën medi e ndiqni rregullisht:

- Shërbimin publik (MTV)
- TV kombëtare private (Kanal 5, Sitel, Telma, 24 News, Alfa)
- On line stacione televizive dhe portale (TV NOVA dhe të tjerët)
- Televizione lokale (TV KISS ..)
- Televizionet e komuniteteve
- Stacionet televizive në rajon (HRT, RTS, TV Pink, TV N1, HAPPY TV)
- Stacionet televizive të huaja (CNN, Al Jazeera, BBC ..)
- Nuk e di / Refuzon të përgjigjet



Ajo që shqetëson veçanërisht në bazë të përqindjeve është fakti se këtu transmetuesi publik në aspekt të publikut, po vdes, pasi vetëm 3.9% të qytetarëve që morën pjesë në anketë thanë se rregullisht e ndjekin këtë shërbim (RTVM). Përveç kësaj, vetëm 11% e qytetarëve i besojnë shërbimit publik, ndërsa përqindja e njerëzve të cilët ju besojnë televizioneve private kombëtare është shumë më e lartë (52.2%). Rezultatet e tilla vetëm se konfirmojnë se sistemi ynë mediatik devijon nga modeli i sistemeve të mediave evropiane, ku ekzistenca e një shërbimi të fortë dhe të pavarur të transmetuesi publik është një nga karakteristikat e tyre kryesore dhe me vlerë. Në vendet e zhvilluara evropiane me traditë të gjatë demokratike në përgjithësi mund të përfundohet se shërbimet publike në thelb e ndjekin politikën zyrtare shtetërore (si shembulli i BBC në Britaninë e Madhe), e jo politikën dhe ideologjinë e partisë në pushtet, siç është tipike për ne.

Sa i përket se si qytetarët e vlerësojnë cilësinë dhe nivelin e objektivitetit të informacionit rreth politikës dhe zhvillimeve politike, anketa tregoi se emisionet informative, ditari, apo të quajtura gjerësisht Lajme (qoftë të paraqitura në televizion, radio, gazeta apo portale informative) kanë besueshmëri më të lartë, apo shumica e të anketuarve (39.2%) besojnë se informacione/njohuri më objektive merren nga Lajmet. Për 29.4 për qind e të anketuarve informacione të besueshme ofrojnë emisionet si: "Top tema" Telma, "360 Gradë" Alsat-M, "Samo vistina" (Vetëm të vërtetën) në Kanal 5, "Xid" (Muri) në Alfa. Në këtë kontekst, një tregues i rëndësishëm i perceptimit të objektivitetit të qytetarëve për mediat kryesore në vend mund të jenë të dhënat se shumica e njerëzve zgjedhin për të shikuar Lajme në një nga televizionet private kombëtare. Njëkohësisht, vetëm 5.9% e tyre kanë thënë se shikojnë lajmet në kanalën e parë të programit të transmetuesit publik MTV 1, dhe vetëm 0.2% në kanalën e dytë të programit MTV2, i cili transmeton program në gjuhët e kombësive, që është edhe një tregues tjetër se sa i ulët është reputacioni i shërbimit publik për qytetarët.


Çfarë është besimi i qytetarëve në media dhe gazetari në vendin tonë?

Ky hulumtim ka konfirmuar se qytetarët kanë qasje në një numër relativisht të madh të mediave. Të pyetur se sa stacione televizive kanë në dispozicion ose marrin në shtëpinë e tyre, shumica e të anketuarve (86, 5%) raportuan se kanë qasje të më shumë se pesë televizioneve.

Ky parametër është një nga parakushtet e rëndësishme për vendin (të paktën formalisht) të përfshihet në mesin e vendeve që thuhet se kanë sisteme të zhvilluara mediatike, ku qytetarëve ju mundësohet të informohen nga një numër i madh i mediave të pavarura dhe të lira. Një gamë hulumtimesh krahasuese konfirmojnë se⁷ mediat e lira dhe qasje në shumë media do të thotë më pak korrupsion, efikasitet më i madh i administratës publike, stabilitet më të lartë politik, sundim i ligjit si dhe parametra më të mira socio-ekonomike.

Por, pavarësisht numrit të madh të mediave të cilat kanë qasje qytetarët, tregues i të cilit është numri i stacioneve televizive në dispozicion për të ndjekur nga shtëpitë e tyre, nga pikëpamjet e të anketuarve mund të konkludohet se shumica prej tyre tregojnë skepticizëm dhe rezervime në lidhje me objektivitetin e përmbajtjeve informative të transmetuara përmes mediave kryesore në vend. Në mbështetje të këtij përfundimi flet edhe fakti se 66, 3% e qytetarëve të anketuar besojnë se mediat kryejnë propagandë politike. Gjithashtu, shumica, apo gjysma e qytetarëve (50.6%) thonë se ata ndjekin lajme (TV Lajme) në më shumë se dy, dhe një e katërta e tyre (22.2%) ndjekin lajme në dy televizione. Në të njëjtën kohë, shumica e qytetarëve (71, 7%) i ndjekin ditaret televiziv në media të orientuara në mënyrë të ndryshme (pro-qeveritare apo opozitare), ku 32.6% e të anketuarve thanë se këtë e bëjnë rregullisht, ndërsa 39.1% ndonjëherë.

I ndjek TV ditaret (lajmet) në media të orientuara në mënyrë të ndryshme (pro-qeveritare, opozitare):



- Rregullisht
- Nganjëherë
- Kurrë
- Nuk e di / Refuzon të përgjigjet

Këto të dhëna mund të interpretohen si tregues i politizimit dhe ndarjes së thellë në sektorin e mediave në vend (në “tuaj” dhe “tanët” apo “pro-qeveritare” dhe media “opozitare”), e cila është një lloj reflektimi i polarizimit të thellë në shoqërinë tonë. Ndoshta për këtë shkak shumica e qytetarëve (kumulative 68%) janë deklaruar se në baza ditore (39, 5%) ose ndonjëherë (28.5%), i kontrollojnë informacionet që i marrin nga mediat, për shembull, me anë të komunikimit ndërpersonal me të afërmit, kolegët, miqtë apo të njohurit.


Anketa tregon qartë se një nga burimet e mundshme të mosbesimit të qytetarëve në media

⁷ Pipa Noris, në Comparing Political Communication Theories, Cases and Challenges, Frank Esser, Barbara Pfetsch, Cambridge University Press, Përkthime: Shtypi Akademik, Shkup, 2009: fq.128

dhe gazetarët buron nga dyshimet për korrupsion. 52.4% e të anketuarve janë të sigurt se në media ka korrupsion apo ryshfet për të arritur ndikimi i tyre dhe presioni, si dhe të bëhen kërcënime ndaj gazetarëve për instrumentalizimin e tyre. Për 28% të qytetarëve vetëm disa gazetarë janë të korruptuar.

A mendoni se ka korrupsion në media, d.m.th. mënyra të mundura për të paguar ryshfet/ndikim/kërcënime ndaj mediave?

- Po
- Jo
- Të korruptuar janë vetëm disa gazetarë individual
- Nuk e di / Refuzon të përgjigjet




Në formimin e besimit të qytetarëve në media dhe gazetarët të rëndësishme janë aspektet që lidhen me shpifje, fyerje dhe përhapjen e gjuhës së urrejtjes. Përkufizimi i nënkuptuar i gjuhës së urrejtjes është përfshirë në Rekomandimin nr. R (97) 20 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi “gjuhën e urrejtjes” të vitit 1997⁸. Në Shtojcë të Rekomandimit theksohet se termi “gjuha e urrejtjes” duhet të kuptohet si një term, që përfshin të gjitha format e shprehjes me të cilat përhapen, nxisin, promovojnë ose justifikojnë urrejtjen racore, ksenofobinë, antisemitizmin ose forma të tjera të urrejtjes në bazë të intolerancës duke përfshirë: intolerancën e shprehur në formën e nacionalizmit agresiv dhe etnocentrizmit, diskriminimit dhe armiqësi ndaj pakicave, emigrantëve dhe njerëzve me origjinë emigrante. Përveç fjalimit të drejtpërdrejtë, gjuha e urrejtjes përfshinë shumë forma të tjera të shprehjes, të tilla si përdorimi publik i simboleve fyese (p.sh. svastika), shfaqje e qartë e tyre në parada, protesta, fjalime publike, etj, shkatërrimin e simboleve fetare dhe kombëtare (flamuj, kryqe, etj), ngjitja e posterave me përmbajtje fyese, ndarja dhe shpërndarja e fletushkave me përmbajtje të tillë, përhapja e urrejtjes përmes TV dhe radios, dhe më kohët e fundit edhe përmes internetit dhe rrjeteve sociale, ku ky fenomen po intensifikohet. Gjuha e urrejtjes dhe shprehjet që përmbajnë elementet e saj kanë një ndikim të dëmshëm, nëse përhapen nëpërmjet mediave apo mediat janë një mjet ideal për përhapjen e gjuhës së urrejtjes apo krijuesit të atmosferës për urrejtje, që më tej e rrisin përgjegjësinë e tyre në këtë fushë si dhe përgjegjësinë e gazetarëve.

⁸ Rekomandimi nr.R(97) 20 i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi “gjuhën e urrejtjes”, në dispozicion në: http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/media/doc/cm/rec%281997%29020&expmem_EN_Asp

Të pyetur nëse gazetarët/mediat në vend përhapin gjuhën e urrejtjes, më shumë se gjysma e qytetarëve 57.9% thanë se po, ndërsa 34% e të anketuarve thanë se gazetarët / mediat nuk e përhapin gjuhën e urrejtjes. Por, pyetja është nëse qytetarët e dinë se çfarë është gjuha e urrejtjes dhe nëse mund ta dallojnë shembull nga shpifja dhe fyerja? Në këtë drejtim atyre ju ofruan deklaratat që u desh të njihin dhe vlerësojnë nëse këto deklaratat janë gjuhë e urrejtjes. Kështu, 59.3% e të anketuarve përmendin deklaratën “shqiptar i keq” dhe 56% “cigan i pistë” si gjuhë e urrejtjes.

Cila nga këto deklaratat përbën gjuhën e urrejtjes?



Megjithatë, 48.3% e qytetarëve shprehjen “ai është politikan i korruptuar”, e klasifikojnë si gjuhë urrejtjeje, edhe pse ai në përkufizimin teorik dhe ligjor nuk klasifikohet si gjuhë eksplicite e urrejtjes.


Në anën tjetër, shumë shpesh mediat dhe publiku të ne nëpërmjet “etiketimit” të zyrtarëve të zgjedhur dhe politikanëve, të tilla si “i korruptuar”, “i pandershëm”, dhe kështu me radhë shprehin dyshim të legjitim dhe e vënë “nën thjerrëz” veprimtarinë e tyre, me të cilat të qytetarët krijohet perceptimi i gabuar në përqindje të lartë të përhapjes së gjuhës së urrejtjes në mediat tona.

Ajo se mendimi dominant i qytetarëve për mediat dhe gazetarët nuk është i favorshëm, tregojnë treguesit e mëposhtëm: Në pyetjen nëse gazetarët/mediat shpifin për politikanë apo përfaqësues të elitës së biznesit, gjysma e qytetarëve 50.4% besojnë se vetëm disa gazetarë e bëjnë atë, dhe 29.7% besojnë se të gjithë gazetarët shpifin. Një përqindje më e vogël e 13, 7 e qytetarëve besojnë se gazetarët nuk shpifin. Përqindje të ngjashme kemi edhe kur është fjala për ofendim.

Gjegjësisht, në mënyrë kumulative, 70, 6% e të anketuarve besojnë se në mediat përdoren ofendime në baza kombëtare, etnike dhe politike, etj. Nga këta të anketuar, 45, 1% besojnë se ofendojnë vetëm disa gazetarë, dhe 25.5% që të gjithë ofendojnë. Vetëm 24, 8% e të anketuarve mendojnë se gazetarët apo mediat nuk ofendojnë.

A është e vrtetë se gazetarët ofendojnë në baza politike, kombëtare, ose të tjera?

- Po
- Jo
- Disa nga gazetarët e bëjnë atë
- Nuk e di / Refuzojnë të përgjigjet



Analiza e rezultateve të anketës tregon se 82% e qytetarëve mendojnë se në mediat vendore shkelet apo cenohet dinjiteti i personit. Nga këto 37, 2% mendojnë se mediat shpesh, dhe 44.8% vetëm ndonjëherë e kërcënojnë dinjitetin

Në këtë hulumtim janë testuar qëndrimet e qytetarëve në lidhje me atë nëse mediat në vend e respektojnë prezumimin e pafajësisë. Ajo në sistemin tonë juridik është përcaktuar si kategori kushtetuese (neni. 13 i Kushtetutës së RM) dhe më tej është përpunuar në Kodin e Procedurës Penale (neni 2 i KPP). Kjo është pjesë e të gjitha akteve ligjore bazë ndërkombëtare mbi të drejtat dhe liritë e njeriut⁹.

Të pandehurit kanë të drejtën e një gjykimi të drejtë, pa u gjykuar nga mediat. (Crociani and others v. Italy, 1980 22 D.R., 147) Shfaqja e pamjeve gjatë paraburgosjes, publikimi i identitetit të të dyshuarit, raportimi mbi rastet gjyqësore (transmetim direkt nga gjykatorja) është me të vërtetë senzacionale dhe e rrit shikueshmërinë. Kjo dëshmohej si teknikë veçanërisht e vlefshme e marketingut publik të cilin e kemi hasur në vend, e cila kishte për qëllim të tregojë efikasitetin e shtetit në luftën kundër krimit, krimit të organizuar, korrupsionit dhe kështu me radhë. Por ky lloj i raportimit vazhdimisht e ka shkelur parimin kushtetues të prezumimit të pafajësisë, sipas të cilës një person i akuzuar për një vepër penale prezumohet i pafajshëm derisa fajësia e tij është përcaktuar me vendim gjyqësor të plotfuqishëm.

Në këtë kuptim, në rastin e përmendur Krocijani kundër Italisë, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut është i mendimit se liria e shtypit mund të kufizohet me detyrimin që shteti të sigurojë për të akuzuarit të kenë gjykim të drejtë, pa u gjykuar nga shtypi (Crociani and others v. Italy, 1980 22 D.R., 147). Qëndrimin e njëjtë, e ka pasur Gjykata edhe në rastin Hodgson, Woolf Productions and the NUJ v. UK, 1988, 10 E.H.R.R., 503) duke thënë se nevoja për të siguruar një gjykim të drejtë dhe për të mbrojtur porota nga ndikimet mund të konsiderohet si

⁹ Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut (neni 11, parag.1); Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (neni 14, parag.2), Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut (neni 8, paragrafi2); Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Neni. 6 para.2) Vëmendje të veçantë për prezumimin e pafajësisë përkushton edhe Bashkimi Evropian, i cili miratoi "Librin e Gjellbër mbi prezumimin e pafajësisë" (Green Paper on the Presumption of Innocence COM (2006)174).

një nevojë e rëndësishme shoqërore, e cila mund ta justifikojë kufizimin e lirisë së shtypit nga neni 10 KEDNJ, me atë që ato kufizime duhet të jenë proporcionale.

Këshilli i Nderit¹⁰ te Shoqata e gazetarëve (SHGM) ka reaguar ndaj njoftimit të më shumë mediave për rastet gjyqësore “Rrjeta merimangës” dhe “Monstra”¹¹. Pra, gjatë raportimit mbi ngjarjet që kanë të bëjnë me rastin “Rrjeta merimangës” Këshilli i Nderit vlerëson se më shumë media nuk e kanë respektuar rregullin e e prezumimit të pafajësisë, duke publikuar identitetin e të dyshuarve, që nuk janë persona të njohur për publikun e gjerë, dhe me këtë mënyrë të informimit e kanë shkelur Kodin e gazetarëve. Rregullat për raportimin e personave të dyshuar parashikon mos të zbulohet fotografia e tyre, dhe gjatë publikimit të pamjeve televizive, fotografitë të mbrohen (me mjegullim).

Ky hulumtim tregon se për këtë problem (nëse gazetarët/mediat në vendin tonë nuk i respektojnë prezumcionin e pafajësisë) pikëpamjet e qytetarëve janë të ndara. Shumica e tyre besojnë (38, 4%) se gazetarët në vend nuk e respektojnë prezumimin e pafajësisë, dhe 36.7% u deklaruan se gazetarët / mediat e respektojnë prezumimin e pafajësisë. 22, 4% thanë se nuk e dinë.

Gjetjet kryesore

Rezultatet e hulumtimit tregojnë qartë se besimi i qytetarëve në mediat tona është lëkundur seriozisht. Analiza e përgjigjeve të pyetësorit i zbulon arsyet kryesore për besimin e ulët të publikut në media dhe gazetarinë në vend. Mosbesimi në media lindi nga imazhi negativ i shumë mediave me ndikim (me përjashtime të rralla në mesin e mediave që gëzojnë besimin e qytetarëve), si dhe sjellja e keqe e disa gazetarëve që sipas shumicës së të anketuarve:

- janë të korruptuar (për 52.4% të qytetarëve ka korrupsion në media, ndërsa 28% thonë se disa gazetarë janë të korruptuar);
 - kryejë propagandë politike (66.3% e qytetarëve besojnë se ky është një fenomen i përgjithshëm në media, dhe 17.4% thanë se këtë e bëjnë disa media);
 - shpifin (50.4% e qytetarëve besojnë se disa gazetarë shpifin, dhe 29.7% se të gjitha mediat e bëjnë atë);
 - përhapin gjuhën e urrejtjes (57.9% e të anketuarve e mbështesin këtë pretendim);
 - fyejnë në baza të ndryshme (gjithsej 70.6% e të anketuarve mendojnë se këtë e bëjnë disa gazetarë, por edhe se një dukuri e përgjithshme në mjedisin mediatik në vend);
 - nuk e respektojnë prezumimin e pafajësisë (shumica e të anketuarve - 38.4% mendojnë se gazetarët apo mediat në vend nuk e bëjnë këtë);
 - shkelin dinjitetin e personit (82% e qytetarëve besojnë se kjo është bërë shpesh ose ndonjëherë).
- Në të njëjtën kohë, shumica (60.4%) janë të bindur se mediat nuk mund të ndikojnë në formimin e qëndrimeve dhe vendimeve të tyre në lidhje me atë se për cilin do të votojnë.

¹⁰ Këshilli i Nderit është i vetmi organ vetërregullues i gazetarëve. Detyra e tij kryesore është që të kujdeset dhe të promovojë parimet etike, kriteret dhe standardet e gazetarisë profesionale dhe gazetari të përgjegjshme të listuara në Kodin e gazetarëve. Roli i Këshillit të Nderit nuk është që të jetë censurë ose të imponojë vetë-censurën.


¹¹ Në gjykimin e çështjes “Rrjeti merimangës” janë akuzuar pronari i Televizionit A1 Velija Ramkovski dhe 22 të afërmit dhe bashkëpunëtorët e tij. Këto ndër të tjera akuzohen për evazion fiskal, pastrim parash, abuzim të kompetencave zyrtare dhe dëmtimin e kreditorëve. Pjesa më e madhe e të akuzuarve morëndënime të larta me burg prej 5 deri në 13 vjet. Rezultati i procesit, i cili tërhoqi vëmendjen e shumë mediave dhe shkaktoi turbullira politike në vend, ishte edhe mbyllja e televizionit të parë privat në vend “A1” dhe të përditshmen “Vreme”. Rasti gjyqësor “Monstra” ishte kundër 7 të akuzuar për terrorizëm, posedim të paligjshëm të armëve dhe vrasjen e pesë personave në “Liçenin e smillkovës” në vitin 2012. Për 6 të akuzuar gjykata ju shqiptoi dënime të përjetshme, ndërsa njëri nga të akuzuarit u shpall i pafajshëm.

Shumica prej tyre (52%) as nuk presin nga mediat dhe gazetarët për të zbuluar shkaqet e problemeve të caktuara dhe të ofrojnë zgjidhje për ta, por vetëm për të informojnë për ato. Ky është gjithashtu një tregues i fortë i mosbesimit të qytetarëve ndaj mediave dhe gazetarisë në vend.

- Shkalla e mosbesimit të qytetarëve në media është një rezultat i politizimit dhe ndarjes së thellë në sektorin e mediave në vend në media “pro-qeverisë” dhe “opozitës”, e cila është një lloj reflektimi i polarizimit të thellë politik në shoqëri. Shkaku i arsyeve të shumta që krijojnë mosbesimin e qytetarëve në media, qytetarët kanë një nevojë të qartë që rregullisht ose kohë pas kohe ti kontrollojnë informacionet që ata i marrin nga mediat.
- Përkaj nivelit përgjithësisht të ulët të besimit në media, shumica e qytetarëve (79.8%) besojnë se media mund të jenë një katalizator i fuqishëm për ndryshim shoqëror, dhe se puna gazetareske dhe hulumtimi janë thelbësore për një demokraci funksionale.

A mendoni se puna gazetareske në vend është thelbësore për pjesëmarrjen politike të qytetarëve dhe funksionimin e shoqërisë?

- Po
- Jo
- Nuk e di / Refuzon të përgjigjet



Mediave dhe gazetarëve në përgjithësi iu ngarkohet edhe roli i shprehur i kontrollit aktiv kritik, apo se hulumtimi gazetaresk kontribuon për të zbuluar skandale të shumta, korrupsion dhe forma të ndryshme të nepotizmit. Për shembull, se mediat dhe gazetarët kanë fuqinë dhe kontribuojnë në zbulimin e parregullsive në sistemin, e mendojnë 80.3% e të anketuarve. Kjo përqindje, nga ana e mediave, gazetarëve dhe shoqatave të tyre mund dhe duhet të interpretohet si një mundësi, që duhet të përdoren për ndërtimin e besimit të publikut ndaj gazetarëve dhe mediave.

- **Rezultatet e këtij hulumtimi konfirmuan se shërbimi publik ka shikueshmëri jashtëzakonisht të ulët dhe besim mes qytetarëve.** Nëse merret parasysh se shumica e qytetarëve për temat më të rëndësishme shoqërore informohen nëpërmjet lajmeve televizive (TV Ditareve), atëherë të dhënat për rejtingun e ulët të shërbimeve programore të Televizionit të Maqedonisë duhet të merret shumë seriozisht, sepse me një shërbim të tillë publik është e qartë se në këtë vend nuk ka medium me ndikim publik, përmes të cilit qytetarët në mënyrë objektive do të informohen për politikën zyrtare shtetërore.

2. PERCEPTIMI I GAZETARËVE PËR GJENDJEN NË PROFESION

Gjendja dhe statusi shoqëror i profesionit të gazetarisë

Këtu gazetaria është profesion në përgjithësi i parregulluar, si në shumicën e vendeve evropiane. Ne nuk kemi kritere për hyrje në profesion, siç është rasti me disa profesione të tjera (mjekë, avokatë, arkitektë ...). Përshtypja dominuese është se në media në shtetin tonë, vlen rregulli se secili mund të jetë gazetar, edhe pa kritere formale për nivelin dhe llojin e arsimit. Interesant është fakti se pjesa më e madhe e gazetarëve të anketuar në këtë hulumtim beson se kjo situatë duhet të ndryshohet. Domethënë, kur pyeten nëse mendojnë se për tu marrë me profesionin “gazetar” është e nevojshme të kërkohet ndonjë kriter, 73% e gazetarëve janë përgjigjur pozitivisht, ndërsa vetëm 17.8% kanë thënë se nuk duhet të ketë kriter për të hyrë në profesion. Në pyetjen cilat kritere duhet të kërkohen për të hyrë në profesion, gati gjysma (47.1%) kanë thënë se duhet të jetë diploma specifike për gazetar dhe 39.5% si një kriter e cekin diplomën e arsimit të lartë, dhe një e treta (33.6%) thonë se duhet të kenë licencë, si kriter.

Qëndrimet e këtilla të gazetarëve këtu tregojnë se gazetaret janë të vetëdijshëm për krizën në profesionalizmin. Por problemi me profesionalizmin në gazetari është një problem global, sepse onllajn mediat prodhuan forma të reja të gazetarisë, të tilla si: Blogimi, gazetaria mobile, gazetaria civile, gazetaria për portale etj, ku çdokush mund të jetë gazetar pa përvojë dhe njohuri të mëparshme. Kjo është veçanërisht tipike për gazetarinë në Evropë që e mbështet qëndrimin e gazetarisë si një profesion i hapur (parregulluar). Por kohët e fundit, kur flasin me lajme të rreme, manipulimi ndërkufitar me opinionin publik, vërtetë ngrihet çështja e përgjegjësisë dhe profesionalizmit të atyre që deklarohen gazetarë.


Sa i përket gazetarisë në media tradicionale (televizion, radio, shtyp) që gjithashtu kaluan procesin e konvergencës dhe derregullimit të sigurt d.m.th. ata tani jetojnë në një “formë online” mund të shihet tendenca që më shumë gazetarë në këto media përfshihen me diplomën e duhur. Në një masë më të madhe apo më të vogël, shkollat e gazetarisë¹² në nivel global kanë qasje tradicionale në arsimin e gazetarisë, që nënkupton njohuri dhe përgjithshme gazetareske dhe trajnimin mbi aftësitë gazetareske.

Një tregues tjetër veçanërisht interesant i gjendjes së profesionit të gazetarisë në vend mund të jetë përmes kryqëzimit të përgjigjeve të gazetarëve të anketuar mbi çështjet që lidhen me politikën e personelit në mediat vendase. Gjegjësisht, edhe pse “përshtatshmëria politike” është renditur edhe si faktori i tretë më i rëndësishëm për politikën kadrovike të mediave (punësimi i gazetarëve)

¹² Termi Shkolla është pranuar përgjithësisht si një term apo emër që e përcakton një institucion ose një pjesë të atij institucioni (p.sh., fakultetit, departament, kolegji, divizion).

**Politika e personelit të mediave (punësimit i gazetarëve) në RM është i bazuar në:
FAKTORI MË I RËNDËSISHËM**

- Kualifikimet profesionale dhe karakteristikat personale (aftësi)
- Përkatësia partiake
- Përshtatshmëria politike
- Marrëdhëniet personale apo lobimi
- Nuk e di/RP




megjithatë për numrin më të madh të gazetarëve (47.2%) media ku punojnë është në përputhje me qëndrimet e tyre intime politike. Kjo konfirmon qartë tendencën se gazetarët kanë prirje të punësohen në media që orientimi politik iu përshtatet me qëndrimet e tyre, që është një nga modalitetet dhe shkaqet e vetë-censurimit mbi punën gazetareske. Ky është një fenomen dhe problem global i demokracisë dhe nuk është vetëm këtu. Veçanërisht, në teoritë kritike (Noam Çomski, për shembull) ka të bëjë me konceptin e “zhvatjes së pëlqimit”, kur gazetari është i punësuar në kompani mediatike, financiarisht e fuqishme duhet ta mbështesë qëndrimin e linjës kryesore editoriale dhe të pronarit të medias. Kryeredaktor i gazetës New York Tajms, Rej Kejv, në vitin 1984 hapur ka pranuar “Edhe pse në Tajm punojnë njerëzit me bindje të ndryshme, ata në lidhje me temën që e shkruajnë duhet ta respektojnë qëndrimin e gazetës. Nëse qëndrimi i autorit të tekstit është identik me qëndrimin e Tajm-it, ai tekst mund të futet në gazetë. “ Statusi shoqëror i gazetarëve në vend është i ulët. Për këtë janë të vetëdijshëm edhe vetë gazetarët. Gjegjësisht, 71.2% e tyre mendojnë se gazetarët në vend kanë një reputacion të ulët. Vetëm 3.7% janë të bindur për të kundërtën. Maks Veber¹³ që nga fillimet e gazetarisë këtë situatë e shpjegon me tezën se publiku padyshim e vlerëson profesionin sipas “sukseseve” të më të këqijve, dhe jo të gazetarëve më të mirë. Si faktorë që ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme ndaj statusit dhe vlerësimit të profesionit të gazetarisë në aspektin shoqëror, në literaturën shkencore janë: korrupsioni, organizimi i sistemit të mediave (sidomos legjislacioni medial) dhe (mos) arsimimi dhe (jo) profesionalizmi i disa gazetarëve.

¹³ Në “Politika si profesion”, Veber thotë: “Gazetari i takon një lloj të autsajderëve, që në shoqëri vazhdimisht vlerësohet sipas zyrtarëve të tyre etik më të poshtëm”. Veber mendon, megjithatë, se gazetari i vetë-besueshëm, i shquar, si individ mund të gëzojë respektin më të madh dhe reputacionin sesa një mjek, por prestigji profesional i gazetarëve kurrë nuk do ta arrijë atë të mjekëve.

Sa i përket korrupsionit, është fakti tronditës se 89.6% e gazetarëve besojnë se ka gazetarë të korruptuar në vend. Sipas 36.9% e gazetarëve të anketuar

Për reputacionin e ulët të gazetarëve shkaqet i shoh në:

- Organizimin e sistemit të mediave (legjislacioni i mediave)
- Mosarsimimi i gazetarëve
- Korrupsioni i gazetarëve
- Nuk e di/RP



pikërisht korrupsioni në mesin e gazetarëve është arsyeja kryesore për reputacionin e ulët të profesionit të gazetarisë në vend. Rreth 30.6% e të anketuarve si arsyen e dytë të rëndësishëm për gjendjen e ulët shoqërore të gazetarisë është organizimi i sistemit të medias, veçanërisht legjislacioni ynë mediatik.

Pavarësisht këtyre të dhënave, 76.7% e gazetarëve të anketuar janë të mendimit se qytetarët ende kanë besim të pjesshëm në punën e tyre. Ky optimizëm në mesin e numrit më të madh të gazetarëve ndoshta është për shkak të besimit të tyre se për imazhin e keq në gazetarinë në publik, megjithatë janë fajtor individët, dhe jo të gjithë profesionistët.

Edhe pse rezultatet e këtij hulumtimi treguan se perceptimi i shumicës së qytetarëve në këtë vend është se shpifjet, ofendimi, gjuha e urrejtjes, shkelja e dinjitetit, mosrespektimi i prezumimit të pafajësisë dhe propaganda politike janë fenomene të shfaqura në media, 87.1% e gazetarëve janë deklaruar se kundër tyre nuk ka procedurë për shpifje, ofendim apo gjuhë të urrejtjes. Kjo përgjigje nga gazetarët hap dilemat: së pari, nëse fenomenet si shpifje, ofendim dhe gjuhë e urrejtjes nuk janë të përhapura gjerësisht dhe tipike për gazetarinë tonë, dhe e dyta nëse qytetarët kanë një nivel të ulët të kulturës ligjore, apo mosbesim në gjyqësorin, dhe prandaj nuk i adresojnë rastet e tilla. Sigurisht, këto çështje meritojnë vëmendje të mëtejshme dhe hulumtim.


Gjithashtu ngrihet pyetjen nëse disa nga gabimet që i bëjnë gazetarët në aspekt të fenomeneve të lartpërmendur të shpifjeve, ofendimeve dhe gjuhës së urrejtjes mund të bëhen edhe për shkak të mosnjohjes së çështjeve dhe rregullimit ligjor. Prandaj gazetarët që morën pjesë në hulumtim janë pyetur nëse janë të informuar me direktivën ligjore që e përcakton punën gazetareske. Rezultatet e fituara nga anketa tregojnë qartë se gazetarët e anketuara konsiderojnë se (54.6%) tërësisht, ose (38.7%) pjesërisht janë të njohur me direktivën ligjore që e përcakton punën gazetareske. Megjithatë, te 55.8% e të anketuarve mbizotëron që direktiva ligjore në vend nuk i plotëson nevojat e gazetarisë hulumtuese.

A ka presione dhe kërcënime ndaj gazetarëve dhe si janë të mbrojtura interesat e profesionit në vend?

Ky hulumtim ka treguar se shumica e gazetarëve të anketuar (52.8%) kanë raportuar se personalisht nuk janë ballafaquar me presion apo kërcënim nga punëdhënësit e tyre/media ose ndonjë palë tjetër. Vetëm 28.8% janë përgjigjur pozitivisht në këtë pyetje. Krejt i kundërt është mendimi për presionet dhe kërcënimet ndaj gazetarëve që merren me gazetari hulumtuese. 64.4% e të anketuarve besojnë se këto gazetarë përballen me presione dhe kërcënime.

Gazetarët që merren me gazetarinë hulumtuese a përballen me presione dhe kërcënime?


- Po
- Jo
- Pjesërisht
- Nuk e di/RP



Nga këto qëndrime vjen përfundimi se numri më i madh, gazetarinë hulumtuese e perceptojnë si të rrezikshme në krahasim me atë klasike.

Duke pasur parasysh rritjen e numrit të rasteve të publikuara në të cilat gazetarët u janë nënshtruar sulmeve dhe procedurave gjyqësore në vitet e fundit, duket pak konfuze fakti se numri më i madh i gazetarëve të anketuar (42.9%) nuk janë përgjigjur në pyetjen nëse mund të kujtojnë emrin e ndonjë gazetari i cili ka qenë “viktimë e punës së tij” te ne, ose në rajon. Vetëm një e treta (32.5%) kanë deklaruar se mundën, ndërsa pothuajse një e katërta (25.5%) nuk mund të kujtojnë emrin e dikujt prej kolegëve të tyre i cili për punën e tij ka qenë objektiv i sulmeve dhe persekutimit. Megjithatë, nga gazetarët që mbajnë mend emrin e ndonjë gazetari i cili ka qenë “viktimë e punës së tij,” shumica e tyre (87.2%) thanë se e kujtojnë Tomislav Kezharovskin.

Mund të ju kujtohet emri i një gazetari i cili ishte „viktimë e punës së vet“ në vend ose rajon?



- Po, emri i tij është
- Jo
- Pa përgjigje

Ky rezultat nuk është befasues, duke pasur parasysh se procesi gjyqësor kundër gazetarit Kezharovski tërhoqi vëmendjen e madhe të publikut, shkaktoi trazira politike dhe protesta të disa organizatave qytetare dhe u veçua në raportin e KE-së si një shembull i presionit politik mbi mediat dhe gazetarët.

Sindikata dhe shoqatat profesionale janë faktor jashtëzakonisht i rëndësishëm për integritetin e një profesioni dhe besueshmërinë e tij në shoqëri. Niveli i integritetit të “esnafit” është një garanci për etikën më të lartë në veprimtari, besueshmëri më të madhe si dhe status më të lartë shoqëror të një profesioni. Kriza e zgjatur politike ka pasur pasoja edhe në këtë sferë. U prish thelbi i esnafit, u formuan shoqata profesionale gazetareske në baza politike, ashtu si në fushat tjera shoqërore në vend, ku u formuan shoqata paralele, që është krejtësisht joprofesionale.

Rezultatet e këtij hulumtimi tregojnë se 42.9% e gazetarëve të anketuar, aspak dhe 39.3% vetëm pjesërisht, ndihen të mbrojtur nga sindikatat e gazetarëve në vend. Kjo përgjigje e konfirmon përfundimin se në vendin tonë në përgjithësi, si dhe nivelin e profesionit të gazetarisë ekziston një krizë e organizimit sindikal.


Në të njëjtën kohë, përqindja është shumë e lartë e gazetarëve të cilët nuk janë anëtarë të ndonjë shoqate profesionale. Thua se është i barabartë shpërndarja e përgjigjeve të gazetarëve të cilët thanë se ishin anëtarë (50.3%) dhe ata të cilët thanë se nuk janë anëtarë (49.7%) të asnjë shoqate profesionale të gazetarisë në vend.

Arsyeja kryesore për përqindjen e lartë të gazetarëve të cilët nuk janë anëtarë të Shoqatave, me siguri është ajo që gazetarët mendojnë se këto shoqata nuk e bëjnë punën e tyre dhe nuk veprojnë në mënyrë aktive në zgjidhjen e problemeve kryesore, çështjeve, informacioneve dhe

mundësitë në profesion. Domethënë, nga numri i përgjithshëm i gazetarëve të anketuar, 44.2% thanë se nuk janë sensibilizuar mjaft nga shoqatat profesionale mediatike, ndërsa 22.7% thanë se shoqatat e gazetarëve bëjnë mjaftueshëm, si për anëtarët e tyre aktual ashtu edhe për ato potencial.

Një nga treguesit se ka një mosbesim kronik i gazetarëve ndaj shoqatave profesionale shihet në përgjigjet që kanë të bëjnë me politizimin e mundshëm të shoqatave të tilla. Mendimi i 28.8% të gazetarëve është se shoqatat profesionale të gazetarëve në vend janë të politizuara, ndërsa vetëm një e teta e gazetarëve (12.9%) besojnë se shoqatat profesionale të gazetarëve nuk janë të politizuara.

Shoqatat profesionale të gazetarëve në vend janë të:



Por fakti që shumica e gazetarëve (58.3%) nuk kanë asnjë qëndrim mbi këtë çështje tregon se numri më i madh i gazetarëve nuk i perceptojnë shoqatat er esnafëve, si faktor relevant veprimtaria e të cilëve, profesioni, si dhe ata vetë do të kishin ndonjë dobi.

Gjithashtu, shumica e gazetarëve (87.7%) nuk shohin dobi as edhe nga anëtarësimi në një shoqatë ndërkombëtare të gazetarisë, edhe pse organizata të tilla si Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve¹⁴, Instituti ndërkombëtar për shtyp dhe Shoqata Ndërkombëtare e Botuesve ofrojnë shumë mundësi për mbrojtje dhe avancim në profesionin gjatë nivele individuale (përmes granteve, bursave, trajnimeve, etj), si dhe me veprimet dhe raportet e dhura e kthejnë vëmendjen e publikut për probleme të caktuara, të tilla si instrumentalizimi mediatik, (mos)transparenca e institucioneve dhe niveli i korrupsionit në vendet. Në këtë mënyrë ata mbështeten nga organizatat e shoqërisë civile, që janë të specializuara në lirinë e shtypit dhe të medias, të tilla si organizata “Reporterët pa kufij”, Organizatat jo-qeveritare të cilëve si një fushë me interes dhe të punës janë të drejtat e përgjithshme të njeriut si Amnesty International, International Council on Human Rights Policy etj

¹⁴ SHGM është anëtare e Federatës ndërkombëtare të gazetarëve

Gjetjet kryesore

- Përshtypja dominuese është se në mediat në vend është një rregull që gjithkush mund të bëhet gazetar. Rrugëdaljen nga kjo situatë, shumica e gazetarëve e shikojnë në shtimin e kriterëve për hyrje në profesionin “gazetar” në vendin tonë, por edhe janë të ndarë mbi atë çfarë duhet të jenë ato.
- Mosbesimi i shumë qytetarëve ndaj mediave dhe gazetarisë ka një reflektim edhe mbi reputacionin e profesionit, një fakt që e ndjejnë edhe vetë gazetarët. 71.2% e gazetarëve besojnë se reputacioni i tyre në vend është i ulët, dhe vetëm 2.5% e gazetarëve mendojnë se qytetarët kanë besim të plotë në punën e tyre. Arsyet për reputacionin e tyre të ulët profesional e gjejnë në korrupsionin e gazetarëve individual dhe legjislativin i keq mediatik.
- Nga deklarimi i gazetarëve të anketuarve kur u pyetën në lidhje me presionet e mundshme dhe kërcënimet ndaj punës së tyre gazetareske, mund të konkludohet se perceptimi dominues në profesion është se gazetaria hulumtuese është më e rrezikshme se gazetaria konvencionale apo klasike.
- Bashkimi sindikal dhe esnaf i gazetarëve në vend është në krizë serioze. Vetëm 9.8% e gazetarëve ndihen të mbrojtur nga sindikatat e gazetarëve, dhe gjysma e tyre (49.7%) nuk janë anëtarë të asnjë shoqate të gazetarëve, për shkak se ata nuk janë të njoftuar për përfitimet e tyre. Vetëm 87.7% nuk janë as anëtarë të ndonjë shoqate ndërkombëtare të gazetarëve.
- Këto të dhëna tregojnë nevojën për rritjen e veprimit të sindikatave dhe shoqatave të esnafëve për përfshirje më të madhe dhe pjesëmarrje aktive të gazetarëve dhe punonjësve të mediave në punën e tyre dhe aktivitetet, që kanë për qëllim mbrojtjen e profesionit të gazetarisë dhe forcimit të reputacionit të tyre, vendit dhe rolin në shoqëri.

3. PERSPEKTIVAT PËR ZHVILLIMIN E GAZETARISË HULUMTUASE DHE GAZETARIA QË OFRON ZGJIDHJE

Çfarë është gazetaria huluntuase dhe si ajo dallon nga ajo klasike?

Ekziston një përkufizim i qartë teorik që bën dallim në mes të a.q gazetari klasike dhe huluntuase. Në thelb të çdo gazetarie është huluntimi, por çdo gazetari nuk është gazetari huluntuase. Dallimi që e bën teoria funksionon edhe në praktikë, dhe përbëhet nga sa më poshtë: thellësia dhe gjerësia e huluntimit; puna në grupe; specializimi i gazetarëve në njohuri të thella të problemit; Puna huluntuase të jetë puna e një gazetari, e jo e një studiuesi tjetër profesional, dhe se qasja tematike është një tipar thelbësor i gazetarisë huluntuase.

Thellësia dhe gjerësia e huluntimit - Gazetarisë huluntuase do të thotë një huluntim i plotë dhe afatgjatë të cilit i qëndron në dispozicion i tërë ekipi i reporterëve. Më shpesh, qëllimi është për të gjetur skandal. Në Shtetet e Bashkuara është tradicionalisht, është e zakonshme të gjitha gazetaret ditore të publikojnë “raport të huluntuesit.” Ndryshe në Gjermani, huluntimi është më së shumti i përhapur në emisione të veçanta: revista dhe disa emisione politike në mediat publike.¹⁵

Tema e përpunimit - Në përkufizimet më shesh të cituara të gazetarisë huluntuase theksohet se tema e përpunimit është veçoria e saj thelbësore. Tema duhet të jetë e rëndësishme për komunitetin, në jetë sekret, apo të ketë qëllimi të fshihet dhe të jetë veçanërisht interesante, por edhe relevante për audiencën¹⁶. Pra, qëllimi nuk është rast i izoluar, por problemet dhe situatat sistemike jetike¹⁷. Në të vërtetë prioritet i gazetarisë huluntuase janë fenomenet patologjike shoqërore si krimi, mashtrimi, korrupsioni, skandalet politike dhe ekonomike etj. Bëhet fjalë për huluntim të gjerë që shkon një hap më shumë nga faktet dhe të dhënat që lehtë janë në dispozicion. Për zhvillimin e gazetarisë huluntuase janë të nevojshme kushtet e caktuara: kohë, burime financiare, hapësirë në media (gazeta, TV, radio), gazetare të trajnuar mirë, pronarë dashamirës të mediave dhe redaktorë të angazhuar.

Huluntion gazetari, dhe jo dikush tjetër - Ajo çfarë i jep identitetin gazetarisë huluntuase është domosdoshmëria që huluntimi të jetë vepër e gazetarit, e jo e një huluntuesi tjetër (ekspert, studiues, polic, detektivë). Ky lloj i gazetarisë kërkon shumë punë nga ana e gazetarit në terren, duke mbajtur biseda nëpërmjet intervistave me dëshmitarë apo aktorë në ngjarje të caktuara, konsultim me ekspertë, kërkime në arkivat e të dhënave apo burime të tjera, shpesh edhe duke mbajtur biseda të fshehta etj. Mendohet se gazetaret hetues të sotëm kanë origjinën nga gazetaret Pulicer dhe Herst nga fundi i shekullit të 19-të. Pulicer punën e tij e ka bazuar në luftën kundër korrupsionit dhe mbështetjen e forcave të përparuara të shoqërisë, duke e quajtur atë me termin muckraking journalism¹⁸.

Ekipi huluntues - Shpesh bëhet fjalë për huluntime të mëdha që supozojnë ekzistencën e ekipeve (ekip i përhershëm ose i formuar ad-hok, punë në çifte ose nën drejtimin e kryeredaktorit¹⁹.

¹⁵ Shtefan Rus Mol, Ana Jugoslava Zagorac Kershe, Novinarstvo, Clio 2005, fq.130.

¹⁶ R. Keeble, The Newspaper Handbook, Routledge London and New York, 1994, fq. 320

¹⁷ Fleeson L., Ten Steps to Investigative Reporting, International Centar for Journalists, Washington D.C., 2000, fq. 6

¹⁸ Muckraking është një term që i referohet gazetarëve të cilët i përdorin gazetaret për të luftuar kundër padrejtësisë, ekspozimin e abuzimeve dhe transferimin e informacioneve në publik në lidhje me qeverisjen e keqe.

¹⁹ Sunday Times ishte gazeta e parë britanike në vitet '60 të shekullit të 20 që ka angazhuar një ekip të reporterëve duke vepruar të sinkronizuar për të kryer një huluntim të thellësishëm mbi efektet e dëmshme të ilaçit “Talidomit”, i cili ishte shkakui lindjes së fëmijëve me dëmtime. Raporti i tyre ka fituar çmime të shumta për Gazetari Huluntuase.

A thua në shtet ka një gazetari hulomtuese të vërtetë apo vetëm raste të izoluar të hulomtimit me mbështetje të huaj?

Para se të paraqesim rezultatet e anketës, fokusi i të cilit ishte gazetaria hulomtuese në vendin tonë, ne duhet të kemi parasysh faktin se nga 163 gazetarë të anketuar në hulomtimit, 130 ishin gazetarë të televizioneve, dhe televizioni si medium nuk është më i përshtatshëm për hulomtimit gazetareske. Televizioni vepron mbi parimin *now this*²⁰ (tani kjo) apo forma më e shkurtër e shprehjes gazetareske me cilësi videogjenetike dhe potencial për të tërhequr sa më shumë shikues. Emisionet informative- Lajmet në televizion, nuk janë hapësirë e përshtatshme për këtë lloj të gazetarisë, për shkak të bollëkut të informacionit dhe kohëzgjatjes së kufizuar. Gazetaria hulomtuese, interpretuese apo gazetaria që ofron zgjidhje (solution journalism) në televizion mund të zhvillohet vetëm në emisione speciale të programit informativ të përkushtuar për një temë aktuale. Bëhet fjalë për projekte jashtëzakonisht të shtrenjta që përfshijnë ekipe të tëra të trajnuar me hulomtues special të trajnuar, gazetarë, specialistë, skenografë, redaktorë dhe prezantues. Për këtë lloj të gazetarisë televizive interpretuese kërkohen parakushte të caktuara, të tilla si një kompani televizive që do të jetë e gatshme të lejojë të flitet në lidhje me çështjet e ndjeshme shoqërore, termin i përshtatshëm, kohë për hulomtimit, punë në ekip dhe gjithësi para. Një tjetër lloj i formës që mund të zhvillojë gazetarinë hulomtuese në televizion është dokumentari i dramatizuar²¹, e cila është një përzjerje e fuqishme e fakteve dhe krijimtarisë origjinale, si rezultat i gazetarisë së thellë hulomtuese.

Në kundërshtim me gjendjen e dëshpëruar të mediave tona të shkruara, në nivel global flitet për “valën e tretë” të hapjes së shtypit (në fund të shek.20 dhe në fillim të shekullit të 21), që korrespondon me shfaqjen e internetit. Gazetat vazhdojnë (edhe më shumë) lexohen, por këtë herë në internet. Gjegjësisht, dy tendenca të kundërta e shënojnë zhvillimin global të gazetave moderne: derisa numri i mediave të shkruara është duke u pakësuar, numri i lexuesve vazhdon të rritet. Globalisht, numri i lexuesve të gazetave cilësore në vendet e zhvilluara industriale nuk është i rrezikuar²².


²⁰ N. Postman, *Amusing Ourselves to Death: Public discourse in the age of show Business*, New York, Viking Penguin, 1985, 100.

²¹ Kjo formë te audiencia ka arritur sukses të madh. Por ky zhanër gjithashtu konsiderohet si një hibrid çdoherë parashtrahet pyetja e objektivitetit të tij. Prapa dokumentarit të dramatizuar qëndron punë shumë mujore, madje edhe vite.

²² I. Herbert, *Practising Global Journalism*, Focal Press, Oxford, Aukland, Boston, Johanesburg, Mellburn, New Deli, 2001, VII.


Rezultatet e hulumtimit tonë tregojnë se shumica e gazetarëve (71.2%) në vend janë deklaruar se bëjnë dallimin në mes gazetarisë konvencionale dhe hulumtuese.

A e keni ndarë gazetarinë hulumtuese nga gazetaria konvencionale?



Megjithatë, edhe pse bëjnë dallim mes gazetarisë konvencionale dhe hulumtuese, vetëm 10.4% e gazetarëve të anketuar thanë se puna e tyre kryesore është hulumtim, kundrejt 39.3% e gazetarëve që thanë se raportojnë, dhe 29.4% dhanë përgjigje që transmetojnë informacione, dhe një e gjashta e gazetarëve (17.8%) thanë se i prezantojnë argumentet e të gjitha palëve të prekura. Tri format e theksuara bien brenda fushës së gazetarisë klasike.

A bëni në punën tuaj KRYESORE gazetareske më shumë:



Në kundërshtim me përvojën ndërkombëtare, në shtetin tonë gazetaria hulumtuese nuk është praktikuar si punë ekipore. Në fakt, më shumë se gjysma e gazetarëve tanë (55.2%) nuk kanë qenë pjesë e ekipit hulumtues gazetaresk, ndërsa 36.2% kanë qenë pjesë e këtij ekipi. Vetëm 4.9% e gazetarëve kanë qenë pjesë e një ekipi ndërkombëtar gazetaresk.

Shumë gazeta në mbarë botën, të tilla si revistat Newsweek²³, L'Express²⁴, Spiegel²⁵ dhe Economist²⁶ punësojnë gazetarë - specialistë, tekstet e të cilëve bazohen në hulumtime të thukëta dhe përdorin të dhëna nga institucionet e specializuara dhe dokumentacion, arkivat, bibliotekat, organizatat hulumtuese të opinionit publik, shërbime të agjencive telegrafike etj. Përdorin intervista të sa më shumë bashkëbiseduesve, aktorëve, dëshmitarëve dhe ekspertëve.


Në vendin tonë, specializimi i gazetarëve në fusha të caktuara të ngushta dhe tema, përfaqësohet në mënyrë modeste. Në fakt, ky hulumtim ka treguar se shumica e gazetarëve (76.7%) nuk janë të specializuara për raportim tematik/shkrim dhe hulumtime në një fushë të caktuar.

Për një gazetari cilësore hulumtuese nevojiten standarde të larta profesionale në hulumtim, prandaj për zhvillimin dhe mbështetjen e këtij lloji të gazetarisë janë të rëndësishme: arsimimi, projekte hulumtuese, ndihmë redaksive, rrjetëzim dhe lidhje mes gazetarëve, bashkëpunim me organizatat dhe rrjetet e gazetarëve hulumtues dhe publikime të botimeve. Aktiviteti arsimor duhet së pari të orientohet te gazetarët e rinj, të cilët nuk kanë mundësi që me punë të rregullt në redaksitë, të fitojnë njohuri themelore dhe të avancuara të teknikave të hulumtimit, por si forma më e lartë e gazetarisë u janë paraqitur teknikat sensacionale dhe tabloide. Gazetarët nëpërmjet një seri të punësive trajnohen për metodologjitë hulumtuese dhe teknikat, teknikat deri në qasje të informatave të rëndësishme publike, etikës gazetareske, aspektet ligjore të gazetarisë, për rëndësinë e njohurive informatike etj.

Në këtë vend, shumica e gazetarëve (81%) thanë se nuk kanë përdorë bursa të përshtatshme për trajnim, ndërsa vetëm rreth një e pesta (19%) janë përgjigjur pozitivisht në këtë pyetje. Disa gazetarë që kanë përdorë bursa për përsosje, pothuajse një e treta (32.3%) i kanë përdorë në një shtet tjetër, dhe një e pesta (19.4%) i kanë përdorur nga OJQ-të ndërkombëtare, ndërsa përgjigjet e gazetarëve që kanë thënë se i kanë përdorë bursat nga shteti janë (12.9%) dhe organizatat jo-qeveritare (12.9%) është shpërndarë në mënyrë të barabartë.

Nëse keni përdorur bursa për përsosje specifikon nga kush:

- Shteti
- OJQ
- OJQ Ndërkombëtare
- Shtet tjetër
- Shoqatë e Gazetarëve Profesionistë të Maqedonisë
- Shoqatë profesionale gazetare nga një vend tjetër
- Organizatë ndërkombëtare gazetareske
- Fondacion
- Pa përgjigje



Ky është një tregues i qartë se mbështetja më e madhe për zhvillimin e gazetarisë hulumtuese në vend, vjen nga jashtë.

Në të gjitha redaksitë më të mëdha të botës në kuadër të medias ka departamente të veçanta

²³ <http://www.newsweek.com/>

²⁴ <http://www.lexpress.fr/>

²⁵ <http://www.spiegel.de/>

²⁶ <https://www.economist.com/>

që merren me gazetarinë hulumtuese. Ata janë të përbërë nga gazetarë të cilët në mënyrë të përkryer e njohin zonën që e hulumtojnë, kanë përvojë të mjaftueshme gazetareske dhe njohuri, si dhe një nxitje të fortë financiare. Duket se kjo e fundit është nga pengesat më të mëdha për zhvillimin e këtij lloji të gazetarisë në vend. Domethënë, shumica e gazetarëve (92%) besojnë se puna gazetareske në vend nuk është punë e paguar mirë.

Gazetarët në vend nuk kanë kohë dhe para dhe resurse të tjera për ushtrimin e gazetarisë hulumtuese, apo nuk kanë mbështetje nga redaksia për këtë lloj të gazetarisë. Ndonjëherë problemi është edhe më i madh: mediat nuk kanë ide dhe njohuri për një preokupimi më të thellë me ndonjë problem. Këtu përsëri janë fajtor pronarët dhe menaxherët në media, sepse në përgjithësi mbizotëron ideja se gazetaria hulumtuese nuk është e levërdishme. Këtë e mohojnë përvoja e mediave perëndimore, por edhe pritjet e audiencës.

Në vendin tonë nuk ka asnjë medium që ka një departament për gazetarinë hulumtuese. Mediat shumë pak merren me tema, që nuk janë në krye të një agjende politike. Arsyet për një mbyllje të tillë mediatike duhet të kërkohen te interesat e pronarëve të mediave, presioni standard i drejtpërdrejtë politik, si dhe rritjen e ndikimit të reklamuesit në media. Çështja e transparencës së pronësisë së mediave, kryesisht pronari substancial, dhe jo ai formal është i një rëndësie të madhe për gazetarinë hulumtuese. Rregullimi thelbësor ligjor i strukturës së pronësisë mbi mediat është i domosdoshëm, që do të sigurojë transparencën mbi pronësinë e mediave dhe parandalimin e përqendrimit të medias. Publiku duhet të ketë të drejtë të formojë mendim në lidhje me vlerën e informacionit që mediat e paraqesin në bazë të qasjes së strukturës së tyre të pronësisë dhe njohurive të personave, që për arsye të tjera mund të ndikojnë në politikën redaktuese.


Përkundër situatës në vend, hulumtimi tregoi se shumica e gazetarëve të anketuar (68.1%) besojnë se mediat në vend, mbështesin gazetari hulumtuese, ndërsa vetëm një e teta e Gazetarëve (12.9%) besojnë se mediat vendase nuk e mbështesin gazetarinë hulumtuese.

I A mbështesin mediat gazetarinë hulumtuese:



Të pyetur nëse media ku punojnë mbështet/kërkon nga gazetarët që të angazhohen në raportimin hulumtues, 60.7% e gazetarëve janë përgjigjur pozitivisht, ndërsa më shumë se një e katërta (26.4%) thanë se media në të cilat ata punojnë nuk kërkon nga gazetarët që të merren me gazetarinë hulumtuese.

Media ku punoni a mbështet/kërkon nga gazetarët që të angazhohen në gazetarinë hulumtuese?




- Po
- Jo
- Nuk e di/RP

Në disa vende të Evropës Juglindore ekzistojnë qendra të veçanta për gazetarinë hulumtuese²⁷ që sigurojnë mbështetje organizative, arsimore dhe teknike për gazetarët dhe redaktorët që punojnë në histori hulumtuese. Detyrimi i gazetarëve dhe organizatave të medias është që të inkurajojnë një gazetari të përgjegjshme, serioze dhe hulumtuese²⁸. Qëllimi i këtyre shoqatave është për të treguar metodologjitë dhe strategjitë e mundshme, për të mundësuar kohë, para, mjete, pavarësi dhe burime të tjera për gazetarët që efektivisht merren me tema hulumtuese. Më tej ata iniciojnë projekte të pavarura hulumtuese të cilat janë publikuar në kuadër të botimeve të veçanta, ueb-faqet dhe media të ndryshme. Qëllimi është publikimi i më shumë historive hulumtuese gazetareske, përmes të cilëve do të zbulohen ajo që individë të caktuar, kompani apo organizata duan ta fshihin nga publiku. Shumë shpesh zhvillimi i qendrave të tilla për gazetari hulumtuese është mbështetur nga OJQ-të. Te shumica e gazetarëve në vend ka një kuptim të nevojës për bashkëpunim me organizatat civile, që në botë zakonisht janë ato që e nxisin zhvillimin e gazetarisë hulumtuese.

Anketa tregoi se shumica e gazetarëve (74.2%) thonë se ata bashkëpunojnë/shkëmbejnë informacione me organizatat civile/joqeveritare, ndërsa vetëm 18.4% nuk e bëjnë atë.

A bashkëpunoni / shkëmbimin informacione me organizatat civile/OJQ-të?



Duket se një nga zgjidhjet e mundshme për dalje nga qorrsoaku në të cilin është gazetaria hulumtuese duhet të kërkohet edhe në mbështetjen sistematike të shtetit, që duhet të sigurohet për të inkurajuar zhvillimin e gazetarisë hulumtuese. Kjo mund të bëhet nëpërmjet krijimit të një fondi të veçantë të medias. Ky fond, përmes mekanizmave dhe kriterëve të përzgjedhjes dhe kontrolli të përshtatshëm, duhet të mbështesë gazetarët hulumtues dhe punën e tyre.

²⁷ Rrjeti Global për Gazetari Hulumtuese: www.gijn.org ;BIRN-Balkan Investigative Journalism Network: <http://birn.eu.com/>; Qendra për Gazetari Hulumtuese-Bosna: <https://www.cin.ba/> ; Qendra për Gazetari Hulumtuese -Serbi: <https://www.cins.rs/srpski> ; Netnovinar-Kroaci: <http://www.journalismfund.eu/author/sasa-lekovic>.

²⁸ Shoqata e Pavarur e Gazetarëve në Serbi ka themeluar një Qendër për gazetari hulumtuese e cila zbaton projekte në fushën e gazetarisë hulumtuese.


Gazetari që ofron zgjidhje (Solution Journalism)

Gazetari që ofron zgjidhje, është gazetari efektive që është rezultat i erës së re, mediave të reja dhe kërkesave të tipit të ri të audiencës. Ky lloj i gazetarisë ofron ide për zgjidhje të problemeve të ndryshme shoqërore dhe është përshtatur edhe për nevojat e përdoruesve të rrjeteve sociale. Historia e gazetarisë konfirmon tezën se situatat sociale të krizës janë fushë e jashtëzakonisht e përshtatshme për rritjen sasore dhe cilësore të gazetarisë. Gazetaria që ofron zgjidhje përbëhet nga tre faza. Faza e parë është hulumtim apo gjurmimi i sfondit të ngjarjes, që ka për qëllim t'i përgjigjet pyetjeve kush, çfarë, ku, kur dhe si. Faza e dytë është analiza apo vendosja e ngjarjes në një kontekst më të gjerë shoqëror dhe të përgjigjet në pyetjen pse. Treguesi i zhvillimit të mëtejshëm të ngjarjes, përkatësisht parashikimin e përbën fazën e tretë dhe përgjigjet në pyetjen çfarë më tej. Madje besohet se kjo gazetari duke përdorur metoda të ndryshme të hulumtimit është përgjigje e funksionimit joefikas të institucioneve që ngadalë vijnë në zgjidhje për problemet shoqërore.

Kur analizohen rezultatet e hulumtimit për perceptimin e qytetarëve për mediat, te ne duket se nuk është krijuar ende një klimë e favorshme për zhvillimin e gazetarisë që ofron zgjidhje. Në fakt, më shumë se gjysma e qytetarëve (52.2%) nuk presin nga gazetarët në tekstet e tyre të zbulojnë shkaqet e ndodhisë/ngjarjes/procesit dhe të ofrojnë informojnë.

Nga gazetarët pres (nivel të lartë të njohurive) në tekstet e tyre ti zbulojnë shkaqet e ndodhisë/ngjarjes/procesit dhe të ofrojnë


- Po, pres që në punën e tyre të ofrojnë zgjidhje
- Jo, nuk pres zgjidhje, por vetëm informata
- Nuk kam qëndrim
- Nuk e di / Refuzon të përgjigjet



Shkaku kryesor i këtij perceptimi të qytetarëve për gazetarinë që ofron zgjidhje, pjesërisht pasqyrohet në përgjigjet e pyetjes në lidhje me sasinë e teksteve të tilla gazetareske. Gjegjësisht, gjithsej 62.4% e qytetarëve vlerësojnë se në mediat vendase nuk ekzistojnë (15.3%) ose nuk ka shumë tekste, analiza dhe komente (47.1%) që ofrojnë zgjidhje për probleme të caktuara sociale, politike apo ekonomike dhe vetëm 24.7% vlerësojnë që tekstet e tilla ekzistojnë.

Tekste gazetarësh/analiza/komente që ofrojnë zgjidhje për probleme të caktuara socio-politike dhe ekonomike në mediat?


- Ekzistojnë
- Nuk ekzistojnë
- Nuk ka shumë tekste të tilla/analiza /komente
- Nuk e di / Refuzon të përgjigjet



Një pjesë e shpjegimit për këtë situatë në media mund ta gjejmë në mënyrën e organizimit të tyre dhe edukimit të veçantë të gazetarëve në fusha të caktuara (p.sh. Shëndetësi, politikë, ekonomi, drejtësi, shkenca teknike ...). Gjegjësisht, në bazë të deklaratave të gazetarëve të anketuar, shumica e gazetarëve (76.7%) nuk janë të specializuar për raportim/shkrim dhe hulumtime në një fushë të veçantë, apo paralelisht punojnë në disa fusha, ndërsa vetëm më pak se një e pesta e gazetarëve (17.2%) punojnë në një fushë ku janë të specializuar. Përqindja e ulët e gazetarëve të specializuar në raportim/shkrim dhe hulumtim në një fushë të caktuar, pothuajse një e treta (29.2%) punojnë në fushën e politikës, 20.8% në fushën ekonomike, ndërsa një e teta prej tyre (12.5%) punojnë në fushën e gjyqësorit. Në temat e fushës së “korrupsionit” dhe “krimit të organizuar”, të cilat janë në fokus të gazetarisë hulumtuese në demokracitë e zhvilluara dhe sistemet e tyre të mediave, në shtetin tonë punojnë vetëm 8.2% e gazetarëve, dhe në temat e “shëndetit” vetëm 4.2%, që mund të interpretohet si të dhëna të habitshme dhe krejtësisht të palogjikshme, duke pasur parasysh faktin se kjo fushë ka të bëjë me shëndetin dhe cilësinë e jetës së të gjithë qytetarëve.

**A jeni të specializuar për raportim/shkrim dhe hulumtim në një fushë të caktuar?
Cilën?**

- Gjyqësor
- Sport
- Politikë
- Krimi i organizuar
- Kulturë
- Korrupsioni
- Bujqësi
- Shëndetësi
- Ekonomi
- Desk



Gjetjet kryesore


- 86% e gazetarëve në vend besojnë se puna e tyre kryesore është që të informojnë, të transmetojnë informacionin dhe të prezantojnë argumentet aktuale e të gjitha palëve të prekura. Vetëm 10.4% e tyre e konsiderojnë hulumtimin si punë kryesore madhe gazetareske, dhe 0.6% të papërfillshme, besojmë se nëpërmjet punës gazetareske duhet të propozojnë zgjidhje për problemet sociale. Përveç kësaj, vetëm 17.2% e gazetarëve janë specializuar për një fushë të caktuar, dhe mbi gjysma e tyre (55.2%) nuk kanë marrë pjesë asnjë herë në ekip hulumtues. Këto të dhëna tregojnë qartë se në vendin tonë preferohet dhe praktikohet raportimi klasik gazetaresk në vend të asaj hulumtuese dhe asaj që ofron zgjidhje.
- Mediat duket se të nxitur kryesisht nga interesat e tyre personale politike dhe të biznesit, si dhe idenë e tyre se çfarë është gazetaria hulumtuese, deklarativisht e inkurajojnë, por në realitet nuk investojnë në zhvillimin e saj. Në redaksitë nuk e praktikojnë punën në ekiye, nuk investohet në arsimimin e mëtejshëm dhe përsosjen e gazetarëve dhe redaktorëve, nuk inkurajohet specializimi i tyre për shkrim dhe hulumtim në fusha të caktuara, të tilla si korrupsioni dhe krimi i organizuar dhe nuk sigurohen stimuj të përshtatshëm financiar për stafin gazetaresk, që sigurisht është një nga faktorët e rëndësishëm për zhvillimin e gazetarisë hulumtuese, një përqindje e madhe, përkatësisht 92% e gazetarëve besojnë se puna e tyre nuk është e paguar mirë.
- Gazetarët në vend nuk kanë kohë, para dhe burime të tjera për praktikimin e gazetarisë hulumtuese. Deri më tani më mbështetja më e madhe për zhvillimin e gazetarisë hulumtuese në vend vjen nga jashtë dhe nga organizatat e shoqërisë civile. Shembujt e suksesshëm për këtë lloj të mbështetjes janë projektet në ekipet gazetareske e të cilit, me mbështetjen e donatorëve institucional nga jashtë dhe organizata civile, punojnë në histori hulumtuese që synojnë për të zbuluar probleme të rëndësishme shoqërore dhe për të ndihmuar në gjetjen e zgjidhjeve efikase për ta.

4. PËRFUNDIMI I PËRGJITHSHËM DHE REKOMANDIMET

Rezultatet e këtij hulumtimi vetëm e konfirmojnë tezën se para mediave dhe gazetarisë në vendin tonë ka sfida të mëdha dhe të vështira²⁹. Besimi i qytetarëve në media dhe gazetarët është jashtëzakonisht i ulët dhe është për shkak të disa faktorëve. Dominon përshtypja se profesioni gazetaresk është nënvlerësuar fuqishëm dhe i pambrojtur. Për zhvillimin e gazetarisë profesionale, sidomos asaj hulumtuese i mungojnë resurset, por edhe vullneti, njohuri dhe aftësi.

Për të kapërcyer këtë situatë të skenës mediatike vendore, si dhe për të nxitur zhvillimin e një strategjie moderne, profesionale, dhe në këtë kontekst, edhe gazetari hulumtuese, është e domosdoshme strategjia kombëtare. Në krijimin e strategjisë së mediave në vendin tonë duhet të marrin pjesë strukturat e mëposhtme: shteti, d.m.th. qeveria (përmes ministrive përkatëse); pronarët e kapitalit, përfaqësuesit e profesionit të gazetarisë, OJQ-të dhe institucionet shkencore)

Strategjia duhet të përcaktojë masat specifike në fushat kyçe të mëposhtme:



²⁹ Ky konstatim është përdorur në raportin e dytë të grupit të ekspertëve të Komisionit Evropian i udhëhequr nga Rajnhard Pribe: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14_seg_report_on_systemic_rol_issues_for_publication.pdf

1. Reforma në legjislacionin mediatic – Reforma në Legjislacionin e mediave duhet të bazohet në analiza serioze dhe të detajuara dhe në debat publik. Rregullorja duhet të ndërtojë media imanente të nevojave social - ekonomike të vendit dhe të vendosura në standardet evropiane për mediat. Vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet rregullave që duhet ta forcojnë shërbimin publik (RTVM), duke garantuar pavarësinë e saj financiare dhe redaktuese, duke e lejuar ta përmbush rolin e saj të rëndësishëm shoqëror.

Në këtë aspekt veçanërisht të rëndësishme janë veprimet hulumtuese dhe analizat e sektorit civil të cilat përfshijnë ekspertizë mbi çështjet prioritare për politikën efektive mediatike. Për shembull është analiza nën “Ushtrimin e së drejtës së lirisë së shprehjes, teori dhe praktikë”, gjithashtu pjesë e projektit Gazetaria hulumtuese-roje e demokracisë. Ky publikim në detaje e analizon të drejtën e lirisë së shprehjes nëpërmjet: 1. shqyrtimin e vendosjes së kësaj të drejte, në kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar, 2. Prezantimi i praktikës gjyqësore të gjykatave kombëtare, të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Gjykata Evropiane e drejtësisë në lidhje me këtë çështje dhe 3. Përmirësimi i kuadrit ligjor me konkluzione dhe rekomandime.

2. Arsimi – Duke pasur parasysh zgjerimin e përkufizimit gazetar, domethënë, gjithkush mund të bëhet gazetar pa arsim paraprak, njohuri dhe eksperiencë, kërkohen masa urgjente si nga shoqatat e gazetarëve profesionistë ashtu edhe nga OJQ-të. Shoqatat e Gazetarëve Profesionistë duhet të ofrojnë shërbime si “zyrë ligjore për gazetarët”, që do të sensibilizonte gazetarët dhe do të sigurojë ndihmë ligjore mbi një sërë çështjesh: gjuhës së urrejtjes, shpifjen dhe fyerjen, mbrojtjen e të dhënave personale, të drejtën e autorit etj.

Në këtë drejtim duhet të funksionojë edhe OJQ-të në fokusin e të cilit është kjo çështje. Me rëndësi të veçantë janë projektet që përfshijnë edukimin e studentëve të gazetarisë, gazetarë të rinj dhe gazetarë me përvojë. Ky arsimim joformal është një mënyrë solide për të rinovuar njohuritë dhe të fitojnë aftësi kryesisht për mediat online dhe format e e-gazetarisë që vazhdimisht ndryshojnë.

3. Mbështetja – Për praktikimin e gazetarisë hulumtuese, por edhe gazetari që ofron zgjidhje të nevojshme është mbështetja direkte financiare, edhe atë gazetarëve dhe ekipeve gazetareske nga mediat që pretendojnë rejtungun e tyre ta ruajnë me gazetari cilësisë. Gjithashtu nevojitet mbështetja nga shteti për ato media që tregojnë interes dhe vullnet për gazetarinë hulumtuese dhe gazetari që ofron zgjidhje. Ky lloj i mbështetjes duhet të ofrojë edhe sektori joqeveritar. Mbështetja mund të përbëhet nga forma të ndryshme, të tilla si: pjesëmarrja e profesionistëve të shquar të medias në ekipet redaktuese, mentorimi, ndarja e përvojave dhe natyrisht mbështetja direkte financiare në krijimin e historive hulumtuese, për të cilat do të mund të formohen edhe disa fonde të mediave.

4. Promovimi – Shoqatat mediatike, në bashkëpunim me sektorin civil, së bashku me ndryshimet e rëndësishme duhet të punojnë në promovimin më të zgjeruar dhe më të plotë, që do të shpjegojnë para qytetarëve konceptet, rëndësinë dhe rolin e gazetarisë moderne, veçanërisht të asaj hulumtuese, si dhe rolin e mediave në një shoqëri demokratike. Perceptimi i mediave dhe gazetarisë në vend është e pafavorshme. Edhe pse kjo është një rezultat i gjensjes reale, por për të korrigjuar imazhin janë të nevojshme dhe aktivitete në kuadër të promovimit dhe arsimimit të publikut (qytetarëve).

Bibliografi

- Pipa Noris, Comparing Political Communicaton Theories, Cases and Challenges, Frank Esser, Barbara Pfetsch, Cambridge University Press, превод: Shtypi akademik, Shkup, 2009
- Shtefan Rus Mol, Ana Jugoslava Zagorac Kersher, Novinarstvo, Clio, 2005;
- R. Keeble, The Newspaper Handbook, Routlege London and New York, 1994;
- Fleeson L., Ten Steps to Investigative Reporting, International Centar for Journalists, Washington D.C., 2000;
- N. Postman, Amusing Oureselves to Death: Public discourse in the age of show Bussiness, New York, Viking Penguin, 1985;
- Herbert, Practising Global Journalism, Focal Press, Oxford, Aukland, Boston, Johanesburg, Mellburn, New Deli, 2001;

Dokumentet

- Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut;
- Pakti Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike;
- Konventa Amerikane për të Drejtat e Njeriut;
- Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

Linqe

<https://freedomhouse.org/report/freedom-world/2017/macedonia>

https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2015/20151110_report_the_former_yugoslav_republic_of_macedonia.pdf

https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2014/20141008-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-progress-report_en.pdf;https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2013/package/brochures/the_former_yugoslav_republic_of_macedonia_2013.pdf

https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/pdf/key_documents/2014/20141008-the-former-yugoslav-republic-of-macedonia-progress-report_en.pdf

http://www.iri.org/sites/default/files/2017-9-18_macedonia_poll.pdf

http://www.avmu.mk/images/Analiza_na_pazarot_na_audio_i_audiovizuelni_mediumski_uslugi_za_2015_godina.pdf

http://www.coe.int/t/dghl/standardsetting/media/doc/cm/rec%281997%29020&expmem_EN.asp

<http://www.newsweek.com/>

<http://www.lexpress.fr/>

<http://www.spiegel.de/>

<https://www.economist.com/>

<http://birn.eu.com/>

<https://www.cin.ba/>

<https://www.cins.rs/srpski>

<http://www.journalismfund.eu/author/sasa-lekovic>

https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14_seg_report_on_systemic_rol_issues_for_publication.pdf

